



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 6249/1 Prot.

Tiranë, më 07.10. 2025

URDHËR

Nr. 516, datë 07.10. 2025

PËR

**SHPALLJEN E KONKURRIMIT PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË
PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, të urdhrit nr. 144, datë 01.08.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare dhe drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar”, të urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirimimin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Procedura e konkurrimit për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, do të kryhet në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për pozicionin e zëvendësrejtort të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar do të jetë deri në datën 20.10.2025.

4. Publikimi i kriterëve dhe procedura që do të ndiqet për konkurrimin për pozicionin e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të bëhet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SHTOJCA 1

SHPALLJE PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 26, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, të urdhrit nr. 144, datë 01.08.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare dhe drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar”, dhe të urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar, Ministria e Arsimit shpall procedurat e konkurrimit për pozicionin:

- **Drejtore i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP).**

I. KËRKESAT E PËRGJITHSHME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
6. Të mos jetë larguar nga puna me masë disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

II. KËRKESAT E POSAÇME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve, në arsimin e lartë.
2. Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në drejtim të institucioneve të administratës publike.
3. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbëjnë avantazh (dëshmi, certifikata).

III. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

2. Letër motivimi;
3. Diplomë "Master i shkencave" ose ekuivalente me të (*Për diplomat e fituara jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë*);
4. Listë notash e noterizuar për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve;
5. Certifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
6. Librezë pune (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
7. Fotokopje e kartës së identitetit;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
11. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
12. Vërtetim nga gjykata që nuk ka proces penal.

Të gjitha dokumentat që janë fotokopje duhet të dorëzohen të njësuara me origjinalin.

Aplikimi i shoqëruar me dokumentet e sipërcituar do të dorëzohen nga kandidatët nëpërmjet shërbimit postar në Ministrinë e Arsimit, në adresën: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë.

IV. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR:

1. Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e drejtorisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kontrollon dhe garanton përmbushjen e misionit dhe të objektivave të drejtorisë dhe të detyrimeve që ka AKAP-ja.
3. Koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e drejtorive, sektorëve të AKAP, drejtorive rajonale dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar.
4. Përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për arsimin për zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve në fushën e arsimit parauniversitar, si dhe përpara Sekretarit të Përgjithshëm për sigurimin e mbarëvajtjes së administrimit financiar, burimeve njerëzore, veprimtarisë arkivore dhe dokumentare dhe aktiveve të AKAP në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Informon në mënyrë periodike ministrin përgjegjës për arsimin dhe Sekretarin e Përgjithshëm për problemet e ndryshme në lidhje me planet e punës apo arritjen e objektivave.
6. Raportin tek ministri përgjegjës për arsimin mbi verifikimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së DRAP-ve, ZVAP-ve dhe IAP-ve (publike dhe private) me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

V. VERIFIKIMI DHE SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E LISTËS PËRFUNDIMTARE

Në përfundim të afatit të aplikimit, Komisioni *ad-hoc* pas shqyrtimit të dosjeve të aplikantëve do të shpallë, brenda 3 (tre) ditëve pune listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit: (<https://arsimi.gov.al>).

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe/ose të posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore, për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së e-mail të deklaruar nga çdo kandidat.

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtën e ankimimit brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja dijeni për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së email-it të deklaruar prej tyre. Ankuesit do t'i kthehet përgjigje brenda 2 (dy) ditëve pune duke filluar nga data e përfundimit të afatit të ankimimit.

Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar do të shpallet brenda datës 31.10.2025, në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit: (<https://arsimi.gov.al>). Në të njëjtën datë do të shpallet dhe njoftim për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

VI. FUSHAT E NJOHURIVE MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

1. Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
4. Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
5. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.
6. Vendimi nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar.
7. Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.
8. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar.

VII. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen:

1. Vlerësimi i testimit me shkrim, deri në 60 pikë.
2. Vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë.
3. Vlerësimi për jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Për të kaluar në fazën e intervistës së strukturuar me gojë çdo kandidat duhet të marrë të paktën 30 (tridhjetë) pikë në testimin me shkrim.

VIII. SHPALLJA E FITUESIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Fituesi do të shpallet në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit: <https://arsimi.gov.al>.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së tyre të email-it.